



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

AGJENCIONI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË KOSOVËS/
INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS



BULETINI HIDRO- KLIMATOLOGJIK

TREMUJORI I KATËRT 2016, Nr.4

Prishtinë, Janar 2017

I nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që përmes buletinit hidro-klimatologjik të ju ofrojmë mundësinë që të keni qasje në informacionet për gjendjen hidrologjike dhe klimatologjike gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016. Informacionet e dhëna në këtë bulletin janë kontribut nga aktivitetet që ka zhvilluar Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës, përgjegjësi e të cilit është monitorimi i dukurive dhe elementeve hidrologjike dhe meteorologjike dhe elementeve tjera që ndërlidhen me këtë veprimtari.

Për publikimin e këtij buletini ka qenë një shtytje që të punohët në mënyrë që të arrihet informim më cilësor dhe efikas rreth elementeve dhe dukurive hidrologjike, klimatologjike dhe dukurive ekstreme të motit.

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është që të sjellim para jush informata të rëndësishme rreth gjendjes hidrologjike , meteorologjike dhe klimatologjike, në mënyrë që të ndihmojë lexuesit, institucionet relevante dhe politikëbërësit të orientojnë drejt projektete dhe planet e tyre të veprimit.

Shpresojmë se ky bulletin do të bëhet një burim i rëndësishëm për t'ju ofruar informata të rëndësishme rreth gjendjes hidrologjike dhe klimatologjike në Kosovë.

Dr.sci. Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv i
Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

.....

Ing/Msc. Letafete Latifi , Drejtore e Institutit
Hidrometeorologjik të Kosovës

.....

PARATHËNIE

Hartimi i Buletinit Hidrologjik dhe Klimatologjik është i bazuar në të dhënat e mbledhura nga monitorimi hidrologjik dhe meteorologjik në Kosovë gjatë periudhes 01 Tetor – 31 Dhjetor 2016, realizuar nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovë .

Në buletin hidrologjik dhe klimatologjik është pasqyruar gjendja hidrologjike, klimatologjike dhe rastet e paraqitjes së dukurive ekstreme të motit, janë dhënë fakte nga terreni mbi nivelet e ujrave në lumenjtë e Kosovës, sasia e reshjeve dhe indeksi i standardizimit të reshjeve(SPI) si dhe fakte mbi gjendjen klimatike që përfshinë temperaturat mesatare mujore, temperaturat minimale dhe maksimale mujore, orët me shkëlqim të diellit dhe ditët me reshje shiu gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016. Janë dhënë informacione mbi rastet e paraqitjes së dukurive ekstreme të motit në Kosovë dhe zonat e përfshira me dukuri ekstreme të motit gjatë periudhës për të cilën referohemi në këtë buletin.

Qellimi i këtij buletini është që të mbajë të informuar me të dhënat më të reja institucionet qeveritare dhe joqeveritare për gjendjen hidrologjike në Kosovë, kushtet klimatike dhe dukuritë ekstreme në mënyrë që institucionet relevante dhe politikëbërësit të orientojnë drejt projektete dhe planet e tyre të veprimit.

HIDROMETEOROLOGJIA E KOSOVËS GJATË PERIUdhËS 01 TETOR- 31 DHJETOR

GJENDJA HIDROLOGJIKE NË KOSOVË

Gjendja hidrologjike e lumenjëve të Kosovë monitorohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës përmes Rrjetit të Monitorimit Hidrologjik.

Rrjeti i monitorimit hidrologjik në Kosovë, është i dizajnuar në atë mënyrë, që duke u bazuar në karakteristikat e florës, topografisë, relievit, klimës, etj është bërë vendosja e stacioneve hidrometrike, qëllimi i të cilëve është që në hapësirë dhe kohë, të paraqesin treguesit sasiore, të njërës prej resurseve më të rëndësishme siç është uji. Rrjeti aktual monitorues, përbëhet prej 27 stacioneve hidrometrike (hartat), të cilët janë të shtrirë në të gjitha pellgjet ujëmbledhëse dhe në bazë të lartësisë mbidetare shtrirja e tyre përfshinë nivelet e larta, të mesme dhe ultësirat.

Institut Hidrometeorologjik i Kosovës gjatë periudhës: tetor – nëntor - dhjetorë të vitit 2016 ka monitoruar kushtet hidrologjike në pellgjet lumore të Kosovës, në bazë të specifikave dhe planit dinamikë të përgatitur dhe aprovuar paraprakisht.



Harta1. Rrjeti i stacioneve hidrometrike të Kosovës

Në të gjitha profilet hidrometrike, regjistrimi i niveleve të ujit është bërë pandërprerë, me anë të sensorëve automatik. Në 7 stacione hidrometrike matëse të cilat përfaqësojnë lumenjtë kryesorë të Kosovës, në pikat dalëse të tyre nga territori i vendit në vendet fqinje, janë të vendosura stacionet automatike me qasje në kohë reale, të cilat e bëjnë regjistrimin, ruajtjen dhe transferimin e informacioneve në çdo kohë në serverin qendrorë i cili ndodhet në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës në Prishtinë.

Të dhënat të cilat janë marr nga rrjeti i stacioneve hidrometrike të Kosovës, janë arkivuar në bazën e të dhënave për hidrometeorologji dhe klimë (MCH), ku bëhet edhe kontrolli e cilësisë së të dhënave si dhe përpunimi dhe analiza e tyre sipas kritereve të përcaktuara nga OBM.

Më vazhdim janë paraqitur të dhënat mesatare, minimale dhe maksimale të niveleve të ujit si dhe koha e paraqitjes së tyre (dd/mm/yyyy), në rrjetin e stacioneve hidrometrike të Kosovës, për periudhën tetor – nëntor – dhjetor të vitit 2016.

Tabela 1 Nivelet mesatare, maksimale dhe minimale (cm), për periudhën X—XI– XII- 2016¹

	Station	Lumi	H_max	H_min	H_mes	MAX_AP	MIN_AP	data_max	data_min
2	Drelaj	<i>Bistrica Pejës</i>	1.81	0.40	0.68	2.15	0.33	08.11.2016	02.10.2016
3	Grykë e R.	<i>Bistrica Pejës</i>	1.40	0.42	0.58	1.78	0.41	08.11.2016	02.12.2016
4	Klinë	<i>Klina</i>	1.76	0.46	0.62	2.14	0.45	09.11.2016	31.12.2016
6	Deçan	<i>Bistrica Deçanit</i>	1.03	0.27	0.36	1.24	0.26	08.11.2016	09.10.2016
7	Këpuz	<i>Drini Bardhë</i>	4.29	0.91	1.28	4.81	0.90	09.11.2016	04.10.2016
8	Gjakovë	<i>Ereniku</i>	2.94	0.42	0.75	4.06	0.40	09.11.2016	01.10.2016
9	Piranë	<i>Toplluha</i>	2.96	0.86	1.18	3.63	0.85	09.11.2016	01.10.2016
10	Gjonaj	<i>Drini Bardhë</i>	5.63	1.63	2.17	6.49	1.68	09.11.2016	02.10.2016
11	Prizren	<i>Bistrica Prizrenit</i>	0.88	0.46	0.56	0.98	0.46	09.11.2016	31.12.2016
12	Drenas	<i>Drenica</i>	2.62	0.90	1.17	2.87	0.90	09.11.2016	02.10.2016
13	Lluzhan	<i>Llapi</i>	3.72	0.76	1.01	4.24	0.75	09.11.2016	03.10.2016
14	Nedakoc	<i>Sitnica</i>	3.33	1.39	1.61	3.46	1.39	10.11.2016	31.12.2016
16	Caralevë	<i>Caraleva</i>	1.05	0.17	0.26	1.49	0.15	09.11.2016	14.12.2016
17	Milloshëvë	<i>Llapi</i>	4.09	1.15	1.56	4.27	1.15	10.11.2016	06.11.2016
18	Leposaviç	<i>Ibri</i>	4.11	1.46	1.85	4.31	1.36	11.11.2016	02.10.2016
19	Konçul	<i>Morava Binçës</i>	4.46	1.98	2.41	5.17	1.97	09.11.2016	04.10.2016
21	Domoroc	<i>Kriva Reka</i>	1.46	0.27	0.49	1.81	0.27	09.11.2016	09.12.2016
20	Viti	<i>Morava Binçës</i>	1.09	0.42	0.50	1.19	0.37	09.11.2016	01.10.2016
22	Kaçanik	<i>Nerodime</i>	0.86	0.30	0.38	1.03	0.29	09.11.2016	02.10.2016
23	Brod	<i>Lepenci</i>	1.34	0.57	0.72	1.47	0.57	09.11.2016	31.12.2016
24	Hani Elezit	<i>Lepenci</i>	1.86	0.63	0.88	2.01	0.62	09.11.2016	04.10.2016
25	Mlikë	<i>Brodi</i>	1.16	0.55	0.77	1.30	0.37	09.11.2016	27.12.2016

Nga të dhënat e tabelës (1), vërejmë se të tre muajt karakterizohen me nivele mesatare, të cilat janë në kondita normale duke i krahasuar ato me mesataret e vitit paraprak por nuk ka devijim të theksuar edhe nga vlerat mesatare shumëvjeçare.

Më poshtë po japim, vlerat mesatare dhe karakteristike të niveleve të ujit në pikat dalëse të lumenjve kryesorë nga territori i Republikës së Kosovës në shtetet fqinje:


- **Drinit të Bardhë në Gjonaj** - niveli mesatarë gjatë kësaj periudhe ka qen 217 cm, ai mesatarë maksimal 563 cm, dhe mesatarë minimalë 168 cm. Niveli absolut maksimal gjatë kësaj periudhe është paraqitur më: 09.11.2016, dhe ka pasur vlerë 649 cm, ndërsa niveli minimal absolut prej 163 cm, është paraqitur 02.10.2016.
- **Ibri në Leposaviç** - niveli mesatarë gjatë këtyre muajve ka qen 185 cm, ai më i larti 411 cm, ndërsa niveli maksimal absolut ka arritur 431 m dhe është regjistruar më

¹ H_min_AP dhe h_max_AP, parapet nivelin më të lartë të regjistruar gjatë periudhës referuese (X-XI - XII)


11.11.2016, ndërsa niveli mesatarë minimal 146 cm, dhe minimal absolut 136 cm dhe është regjistruar 02.10.2016.

- **Morava Binçës në Konçul** – niveli mesatarë gjatë kësaj periudhe tre mujore ka qen 241 cm, ai mesatarë maksimal 446 cm, mesatarë minimal 198 cm. Niveli më i lartë absolut ka qen më datë: 09/12/2016 dhe ka arritur në 517 cm, kurse ai mesatarë minimal ka qenë më datë: 04/10/2016 dhe ka pasur vlerë prej 197 cm.
- **Lepenci në Hanë të Elezit** – niveli mesatarë gjatë këtyre muajve ka qen 88 cm, ai mesatarë minimal 63 cm, dhe mesatarë maksimal 186 cm. Niveli më i lartë është regjistruar më datën: 09/11/2016 dhe ka arritur në 201 cm, ndërsa niveli minimal absolut me vlerë 62 cm, ka qen më 04/10/2016.

Grafiku 1. Nivelet mesatare – maksimale dhe minimale X – XI –XII. 2016



Grafiku 1. Nivelet mesatare dhe qëndrueshmëria e tyre në raport me periudhën tre mujore paraprake (VII-IX dhe X-XII/2016)



Grafiku 2. Niveli mesatar (tremujori i katër në raport me tremujorin e tretë) dhe qëndrueshmëria e tyre

Nga grafiku (2), vërejmë që gjatë këtijë tremujori (tetor – dhjetor), nivele mesatare më të qëndrueshme kanë pasur lumenjtë: Bistrica e Deçanit, Ereniku, Toplluha, Drini Bardhë, Bistrica Prizrenit, Llapi, Sitnica,, ndërsa lëkundje më të theksuara edhe pse në masë të vogël kanë treguar lumenjtë: Bistrica Pejës, Lumi Istogut, Lumi Brodit etj, e cila arsyetohet me karakterin e tyre malorë, dhe konditave të ndryshme natyrore dhe klimatike.

GJENDJA METEOROLOGJIKE DHE KLIMATOLOGJIKE NË TREMUJORIN E KATËR

Gjendja meteorologjike dhe klimatologjike në Kosovë monitorohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës përmes rrjetit të monitorimit meteorologjik dhe rrjetit për monitorimit e reshjeve (shih hartën 2).

Rrjeti meteorologjik është një numër i integruar i stacioneve matëse i shpërndarë në gjithë territorin e Kosovës ku kryhen matje kualitative dhe të koordinuara mbi specifikat e lokacioneve. Arkivimi i të dhënave meteorologjike bëhet në softuerin qendror (MCH) të IHMK, përmes të cilit bëhet edhe përpunimi i të dhënave.

Analiza e të dhënave të regjistruara në stacionet meteorologjike gjatë periudhës për të cilën i referohemi në këtë buletin na bënë të kuptojmë se çfarë e karakterizon periudhën tetor-dhjetor 2016.




Harta2. Rrjeti i stacioneve meteorologjike dhe të reshjeve

Temperatura e ajrit- karakterizohet me vlerën e temperaturës mesatare mujore, mesatares mujore të temperaturës minimale, dhe mesatares mujore të temperaturës maksimale si dhe me numrin e ditëve me vlerën e temperaturës mbi ose nën pragun e përcaktuar (varësisht nga sezoni dhe klima karakteristike).


Në vazhdim janë dhënë grafikonet e temperaturave karakteristike të ajrit (grafikoni 3 dhe 4) për stacionet kryesore klimatologjike, përfaqësuese të regjionit të rrafshit të Kosovës/pellgut të Ibrit-stc. në Prishtinë dhe Mitrovicë, rrafshit të Dukagjinit/Pellgut të Drinit të bardhë-stac. në Pejë, dhe pellgut të Lepencit-stac. në Ferizaj.

Nga analiza e grafikoni 3 vërehet se periudha 01 tetor – 31 dhjetor 2016 është karakterizuar me vlera më të ulta të temperaturës mesatare mujore krahasuar me temperaturat mesatare mujore të njëjtës periudhë kohore gjatë periudhës vjetore 1960/1990,d.m.th gjatë vitit 2016 është shënuar një rënie drastike e temperaturave për periudhën e njëjete kohore.

Temperatura minimale gjatë periudhës 01 tetor – 31dhjetor 2016 është regjistruar gjatë muajit dhjetor në stacionin e Ferizajit dhe arrinë vlerën në -11.2 °C, ndërsa temperatura maksimale është regjistruar gjatë muajit tetor në stacionin meteorologjik në Prishtinë dhe arrin vlerën në 26 °C, shih grafikonin 4.




Grafiku 3. Temperatura mesatare mujore në stacionet meteorologjike



Grafiku 4. Temperatura minimale dhe maksimale e ajrit në stacionet meteorologjike

Numri i ditëve me temperatura 15 °C – periudha për të cilën jemi referuar në këtë buletin karakterizohet me numrin e ditëve me temperatura 15 °C, ku gjatë muajit tetor dhe nëntorë në Prishtinë janë regjistruar 1 ditë me temperaturë 15 °C, në Pejë 1 ditë, në Mitrovicë 2 ditë dhe në Ferizajë 2 ditë. Ndërsa gjatë muajit dhjetor nuk është regjistruar asnjë ditë me temperaturë 15 °C shih graf. 4.

Numri i ditëve me temperatura 0 °C - Gjatë kësaj periudhe numri i ditëve me temperature 0 °C ishte : në Prishtinë 32 ditë ku në muajin tetorë ishte regjistruar 1 dite , nëntorë 10 dite dhe dhjetorë 21 dite me temperature 0 °C . Në Pejë janë regjistruar gjithsejtë 43 dite me temperature 0 °C dhe atë gjatë tetorit 1 ditë, në nëntorë 13 ditë dhe në dhjetorë 29 ditë. Në Ferizajë janë regjistruar gjithsejtë 44 dite me temperature 0 °C dhe atë gjatë tetorit 1 ditë, në nëntorë 14 ditë dhe në dhjetorë 29 ditë.



Grafiku5. Numri i ditëve me temperatura 0 °C të regjistruara në stacionet klimatologjike

Numri i orëve me diell (insolacioni) - Ne periudhën monitoruese (01 tetor - 31 dhjetor), janë regjistruar gjithësejt 297.13 h me diell në Prishtinë dhe 290 h në Ferizaj.

Shpejtësia e erës dhe drejtimi dominues - Shpejtësia e erës është specifike e territoreve të caktuar meqë për shkakë të orografisë që ka vendi ynë dhe më konkretisht vargmaleve që e rrethojnë territorin tone , shpejtësia e erës dhe drejtimi dominues ndryshon shumë nga vendi në vend. Shpejtësia më e madhe është regjistruar në Ferizaj 17.2 m/s nga drejtimi i veriperëndimit (NË), në Prishtinë shpejtësia më e lartë ishte 13.0 m/s nga drejtimi i verilindjes (NE), ndërsa në Pejë ishte shpejtësia më e vogël krahasuar me këto dy stacione me vetëm 10 m/s në muajin dhjetor nga drejtimi i veriperëndimit (NË) (zone urbane).

Sasia e reshjeve dhe numri i diteve me reshje shiu- gjatë këtijë tremujori sasia më e lartë e reshjeve ishte regjistruar në Prishtinë dhe Ferizajë ndërsa dukëe shkuar nga veriperëndimi dhe verilindja sasia e reshjeve ishte më e ulët.

Specifik e këtijë tremujori ishte muaji dhjetorë gjatë të cilit është regjistruar sasia më e ulët e reshjeve krahasuar me muajt paraprak. Janë regjistruar vetëm 2 ditë me reshje bore të intensitetit të ulët , trashësia e të cilës ka arritë në 2 cm në pjesën qendrore, perëndimore dhe jugore të

Kosovës, ndërsa në pjesën veriperëndimore(Podujevë me rrethinë) kishte arritë trashësinë deri në 7 cm. Për sezonin dimrorë 2016/2017 bora e parë është regjistruar më 28 nëntore 2016.

Karakteristikë e këtijë tremujori ishte edhe muaji tetorë ku numri i ditëve me reshje shiu kishte arritë në 18 ditë në Prishtinë, 13 ditë në Pejë, 13 në Ferizajë , Podujeve me 5 ditë dhe Mitrovicë ishin regjistruar 7 ditë me reshje shiu. Gjatë muajit tetorë në Prishtinë sasia e reshjeve e regjistruar kishte arritë vlerën në 100.1 mm , në Pejë 57.0mm, Ferizaj 88.2 mm, Podujevë 47.0 mm dhe në Mitrovicë 70.5 mm. Në tetor dhe nëntor Prishtina kishte regjistruar sasi rekorde te reshjeve krahasuar me stacionet tjera meteorologjike, që është specifikë e muajit tetorë, ndërsa në muajin nëntorë sasi rekorde e reshjeve ishte regjistruar në Pejë vlere e të cilës kishte arritë në 179.8 mm, shih grafikun 6.




Fig7. Sasia totale e reshjeve sipas muajve

Sipas numrit të diteve me reshje shiu Prishtina regjistron 29 ditë , Peja 25 ditë, Ferizaj 19 ditë, Podujeva 18 ditë dhe Mitrovica 16 ditë, shih grafikun 7.




Fig.x. Numri i diteve me reshje shi

DUKURIT EKSTREME

PARAQITJA E THATËSIRAVE NË KOSOVË- INDEKSI STANDARD I PRECIPITIMIT(RESHJEVE)-SPI

Situata e thatësirav në lidhje me akumulimin e reshjeve , paraqitet nga Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI). Llogaritja e SPI është e bazuar në shpërndarjen e reshjeve mbi periudha të gjata kohore 30 vjet , ne këtë rastë janë përdorur mesataret afatgjate (1926/1949-2016).

SPI mund të llogaritet në shkallë të ndryshme kohore te cilat pasqyrojnë ndikimin e thatësirës mbi disponueshmërinë e burimeve ujore.

Te dhënat për reshjet e regjistruara për një periudhë të gjatë kohore mundësonë një shpërndarje probabiliteti, e cila është normalizuar më pas në mënyrë që mesatarja SPI për çdo vend dhe periudhë kohore është zero. Vlerat e SPI mbi zero tregojnë periudha me lagështirë dhe vlerat nën zero tregojnë periudha të thata.

Në vazhdim janë paraqitë tabelat e SPI për regjionin e rrafshit të Kosovës/pellgu i Ibrit- stac.në Prishtinë, regjionin e Dukagjinit/pellgu i Drinit të Bardhë- stac.në Pejë dhe pellgun e Lepencit- stac. në Ferizaj.

Year	SP-1	SP-1	SP-1	SP-1	SP-1	SP-1	SP-1	SP-1	SP-1	SP-1	SP-1	SP-2	SP-2	SP-2	SP-2	SP-2	SP-2	SP-3	SP-3	SP-3	SP-3	SP-4	SP-4	SP-4	SP-4	SP-6	SP-6	SP-12											
Year	Oct	Nov	Dec	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
20152012	-0.0	-0.0	-0.0	1.0	-1.0	1.0	0.0	0.0	1.0	1.0	2.0	1.0	-0.0	-0.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0		
20152013	0.0	-0.1	-0.2	2.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	0.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0		
20152014	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0		
20152015	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
20152016	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		

tabela.2. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) për Prishtin

Standardised Precipitation Record (SPI) for Ferizaj. The table shows monthly SPI values for each year from 2000 to 2019. The values range from approximately -2.00 to 1.50. The spreadsheet interface includes a 'Calculate SPI' button and a 'Apply B&W Formatting' option.

Tabela.3. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) për Ferizaj

Standardised Precipitation Record (SPI) for Pejë. The table shows monthly SPI values for each year from 2000 to 2019. The values range from approximately -2.00 to 1.50. The spreadsheet interface includes a 'Calculate SPI' button and a 'Apply B&W Formatting' option.

Tabela.4. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) për Pejë

Tabelat e lartëshënuara pasqyrojnë Indeks të Standardizimit të Reshjeve (SPI) për periudhën 01 tetor -31 dhjetor 2016 në tri regjionet e lartpërmendura. Nga analiza e SPI vërehet se nuk është paraqitë dukuri e thatësirave në asnjërin nga regjionet e Kosovës. Indeksi i standardizimit të reshjeve (SPI-3) për tremujorë, tregon se është paraqitë periudhë me lagështi në përmasa të vlerave normale për Pejë dhe Ferizaj ndërsa në Prishtinë tejkalonë vlerat e normales dhe kalon në suficit (gjendje me lagështi të lartë) e cila tregon rrezikun për vërshime, përkunder faktit se në muajin dhjetorë sasia e reshjeve ka qene minimale dhe SPI-1 ka treguar deficit të reshjeve për muajin dhjetor. SPI-1 për muajin dhjetorë ka treguar deficit në të gjitha staconet monitoruese të reshjeve dhe është shënuar si muaji më i thatë i këtij viti.

PARAQITJA E VËRSHIMEVE NË KOSOVË

Kjo periudhë është karakterizuar me reshje shiu ne disa rast me intenzitet te karte dhe reshje bore. Që nga orët e para të datës 07/11/2016 vendi jonë ishte përfshirë nga reshjet e shiut, fillimisht në pjesën perëndimore dhe veri –perëndimore, të cilat gjatë orëve të pasdites, e patën përfshin tërë vendin, me intensitet të shtuar rreth 20 - 25 mm/3h, apo nga: 60 – 75 mm/24h.

Më datën 08/11/2016, arrihet intenzitetit maksimal i reshjeve, në mesë të 65-90 mm brenda 24 orëve, që në total ishte 125 – 165 mm (litra/m²) e të cilat shkaktuan daljen e rrjedha ujore nga shtratërit e tyre duke shkaktuar vërshime, shih fig.1.

Zonat më të atakuara nga këto vërshime ishin Komuna e Rahovecit, Suharekës, Malishevës, Drenasit, Fushë Kosovës dhe Obiliqit.

Reshjet e shiut me intensitet më të ulët (20 - 40 mm) dhe shpërndarje të pa barabartë hapësinore patën vazhduar edhe më datë 09/11/2016, shih hartën 3 dhe 4 në vazhdim.

Harta 3 dhe 4. Zonat ku rrjedhat ujore kan dalur prej shtretërve të tyre dhe zonat potenciale të përfshira nga vërshimet në Kosovë





Fig. 1. Pamje nga dalja e rrjedes ujore nga shtrati i tyre

BULETINI HIDRO-KLIMATOLOGJIK- TREMUJORI I TRETË 2016, Nr.3

Publikuar nga:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Buletini Hidro-Klimatologjik - tremujori i tretë 2016, nr.3- Është përgatitur nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës .

Përgatitja e buletinit është realizuar nga:

Ing.e dipl./Msc. Letafete LATIFI, *Drjetore e IHMK;*
Dr.sci. Bashkim KASTRATI, *Hidrolog i lartë ne IHMK;*
Msc. Besim ALIU, *Meteorolog në IHMK, stc.në Ferizaj.*

Kontribues në përgatitjen e buletinit janë zyrtarët e hidrologjisë dhe meteorologjisë:

Xhevahire Puraj, *Hidrologe;*
Ing i dipl./Msc. Hasan Hasani, *Hidrolog i lartë;*
Faton Sopi, *Administrator në databazë;*
Beqir Gashi , *Meteorolog, stac. Në Prishtinë*
Bardhyl Ahmetxhekaj,*Meteorolog,stc.në Pejë*
Illir Topalli, *Meteorolog, stc. në Mitrovicë*